

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të pandehurit I. Sh., nga K., për shkak të veprave penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Y. H., nga Gj., si dhe ndaj të pandehurit Sh. Sh., nga K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati M. S., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.146/2015, e datës 08.09.2015, të cilën e përfaqësonte prokurori Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 14.09.2015, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datën 28.09.2015, e përpilojë me shkrim këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri I. SH., nga babai Q. dhe nëna L., e lindur S., i lindur më ..., në K., ku edhe jeton në lagjen "...", shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale,

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse më datën2015, rreth orës ... minuta, në fshatin K., Komuna e K., me qëllim që vetit t'i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror me përdorim të forcës dhe me mjet të përshtatshëm-shufër ka hap me forcë dritaren e banjos së shtëpisë së të dëmtuarit Xh. K., nga i njëjti fshat dhe pasi që ka depërtuar brenda, në dhomën e fjetjes së të dëmtuarit ka marrë armën zyrtare të markës "... me ... karikator dhe ... fishekë dhe më pastaj ka ikur në drejtim të panjohur, kurse me punën operative të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, Njësi i Hetimeve Rajonale në Gjilan, i pandehuri arrestohet,

- me këtë ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 2, nënparagrafi 2.5 të KPRK.

II.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Sepse në kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, i pandehuri në mënyrë të paautorizuar e në shkelje të ligjit të zbatueshëm për armët në Kosovë, ka mbajtur në kontroll dhe posedim, armë të zjarrit edhe atë armën e markës “...” me ... karikator dhe ... fishekë, e të cilën edhe e ka fshehur në vend të caktuar,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

III.

I pandehuri SH. SH., nga babai Q. dhe nëna L., e lindur S., i lindur më ..., në Gjilan, tani me vendbanim në K., lagjja “...”, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i dy fëmijëve, ... , i gjendjes së varfër ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale,

ËSHTË FAJTOR

Sepse në kohë të pa vërtetuar në kundërshtim me ligjin për armët në Kosovë, në mënyrë të paautorizuar në shtëpinë e tij në K., ka mbajtur në pronësi, kontrollë dhe posedim pa leje valide armë të zjarrit edhe atë një pushkë gjuetie, punim dore e cila edhe më datën2015, në K., në lagjen “...”, pas kontrollimit të shtëpisë së të pandehurit, e njëjta armë i është gjetur dhe sekuestruar,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë dhe në nenet 4, 41, 42, 43, 45, 46, 62, 69, 73, 74, 75 dhe 76 të KPP, si dhe në bazë të neneve 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale,² të pandehurit I. Sh., për veprën penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi i shqipton dënim me burgim prej 2 (dy) vjetëve, ndërsa për veprën penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve.

Duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.2. të KPRK, të pandehurit I. Sh., i shqipton

DËNIM UNIK ME BURGIM

Ashtu që të njëjtit i shqiptohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 2 (dy) muaj, të cilin dënim i pandehuri do ta mbaj pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, të pandehurit Sh. Sh., për shkak të kryerjes së veprës penale sipas dispozitivit III të këtij aktgjykimi, i shqipton

DËNIM ME GJOBË

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Ashtu që ndaj të pandehurit Sh. Sh., i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguajë në afat prej 1 (një) muaji, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri Sh. Sh. nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Nëse i pandehuri Sh. Sh., nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Konfiskohet arma e zjarrit – pushka e gjuetisë, e punuar me dorë.

Ndaj të pandehurit I. Sh., është ndërprerë paraburgimi dhe i njëjti është liruar më datën 14.09.2015.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të pandehurit I. Sh., i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.08.2015 e deri më datën 14.09.2015, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim barazohet me 1 (një) të dënimit me burgim.

I dëmtuari Xh. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohen të pandehurit I. dhe Sh. Sh., që secili veç e veç ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 08.09.2015 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurve I. Sh., nga K., për shkak të veprave penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, si dhe ndaj të pandehurit Sh. Sh., nga K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Pas pranimit të aktakuzës, kryetari i trupit gjykues e ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 14.09.2015, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, të pandehurit I. dhe Sh. Sh., kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprat penale për të cilët akuzohen, duke shtuar se e pranojnë fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësve të pandehurve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurëve, pas konsulltimeve të mjaftueshme, me mbrojtësit e tyre, avokatët Y. H. dhe M.

S.; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri I. Sh., me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm e ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, si dhe me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi;

- se i pandehuri Sh. Sh., me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprave penale

Në nenin 327 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të KPRK, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1 i nenit 325 të KPRK ose paragrafi 1 i nenit 327 të KPRK, dënohet me burgim prej prej 3 (tre) deri në 10 (dhjetë) vjet, nëse pasuria e vjedhur është armë”. Ndërsa, në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e kryen “kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind Euro) ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet”. Ndërsa, duke u bazuar në nenet 17 deri 21 të Ligjit për armët,³ është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent. Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin I. Sh., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, si dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vetë, i njëjti me datën ... 2015, rreth orës ... minuta, në fshatin K., Komuna e K., me qëllim që vetit t’i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror me përdorim të forcës mjet i përshtatshëm-shufër ka hap me forcë dritaren e banjos së shtëpisë së të dëmtuarit Xh. K., nga i njëjti fshat dhe pasi që ka depërtuar brenda në dhomën e fjetjes së të dëmtuarit ka marrë armën zyrtare të markës “...” me ... karikator dhe ... fishekë dhe më pastaj ka ikur në drejtim të panjohur dhe këtë armë i pandehuri me ... karikator dhe ... fishekë, në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Armët, e ka mbajtur në kontroll dhe posedim, të cilën edhe e ka fshehur në vend të caktuar.

Në anën tjetër, duke u bazuar në këto dispozita ligjore, kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin Sh. Sh. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vet në kohë të pa vërtetuar në kundërshtim me ligjin për armët në Kosovë, në mënyrë të paautorizuar në shtëpinë e tij në K., ka mbajtur në

³ Ligji nr.03/L-143 për Armët, i datës 17.09.2009.

pronësi pa leje valide armë të zjarrit edhe atë një pushkë gjuetie punim dore e cila edhe më datën ... 2015, në K., në lagjen "...", pas kontrollimit të shtëpisë së të pandehurit e njëjta i është gjetur dhe sekuestruar.

5. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që të pandehurit I. dhe Sh. Sh., t'i shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së lartcekur.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të pandehurit I. Sh., kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73, 74 dhe 75 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës kryetari i trupit gjykues e ka zbutur dënimin, është fakti se i akuzuari I. Sh. e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar dhe këtë e ka bërë edhe gjatë marrjes në pyetje në nga ana e prokurorit të shtetit. Kjo është një rrethanë e cila duke e ndërlidhur me rrethanat tjera të shënuara më poshtë, tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit. Përveç kësaj, si rrethana tjera posaçërisht lehtësuese, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se është penduar për kryerjen e veprave penale; se i njëjti i ka kërkuar ndjesë të dëmtuarit Xh. K. dhe se sipas deklaratës së të pandehurit të cilës trupit gjykues ja ka falur besimin, i njëjti është i martuar dhe është babë i tre fëmijëve. Andaj, duke i marrë për bazë të gjitha këto që u cekën më lartë, kryetari i trupit gjykues ka vlerësuar se në rastin konkret ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese, të cilat tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit. Për këto arsye, kryetari i trupit gjykues ka vlerësuar se shqiptimi i dënimit në kuadër të minimumit dhe maksimumit të posaçëm të kësaj forme të veprës penale (dënim me burgim prej tre deri në dhjetë burgim), me të vërtetë, duke i marrë për bazë të gjitha këto rrethana posaçërisht lehtësuese, do të ishte një dënim shumë i rëndë për të akuzuarin.

Sa i përket të pandehurit Sh. Sh., me rastin e caktimit të dënimit, kryetari i trupit gjykues, si rrethana lehtësuese i ka marrë për bazë faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë; se bëhet fjalë për një pushkë gjuetie, e cila në vehte përmban një shkallë më të ulët të rrezikshmërisë, në krahasim me armët tjera të zjarrit dhe se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës kryetari i trupit gjykues ja ka falur besimin, i njëjti është i martuar dhe është babë i dy fëmijëve. Gjithashtu, me rastin se caktimit të dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues, e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri Sh. Sh., punon si muzicent.

Si rrethana rënduese për të dy të pandehurit, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë faktin se të njëjtit edhe më parë kanë qenë të dënuar për vepra tjera penale. Kështu, i pandehuri I. Sh., është shpallur fajtor dhe është dënuar me aktgjykimet e kësaj Gjykate, Dega në Kamenicë (më parë Gjykata Komunale në Kamenicë), P.nr.109/14, për shkak të veprës penale nga neni 153 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës,⁴ P.nr.115/12, për shkak të veprës penale, nga neni 285 paragrafi 2 të KPK; P.nr.159/13, për shkak të veprës penale, nga neni 225 paragrafi 1 të KPK; P.nr.188/12, për shkak të veprës penale, nga neni 153 i KPK, etj. Kurse, në anën tjetër, i pandehuri Sh. Sh., është shpallur fajtor me këto aktgjykime : P.nr.209/13, për shkak të veprës penale, nga neni 358 paragrafi 2 të KPRK dhe P.nr.5/08, për shkak të veprës penale, nga neni 153 paragrafi 1 të KPK.

⁴ Kodi i Penal i Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPK) - Rregullorja e UNMIK-ut, nr.25/2003, e datës 06.07.2003.

7. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri Sh. Sh. nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

9. Dënimi plotësues

Përveç dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 62, 69 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK, ndaj të pandehurit Sh. Sh., shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja - konfiskimi i armës së zjarrit-pushka e gjuetisë, punim dore.

Sa i përket armën zyrtare të markës “...” me ... karikator dhe ... fishekë, kryetari i trupit trupi gjykues, nuk ka vendosur fare, që të konfiskohet apo që t’i kthehet të dëmtuarit Xh. K., për shkak se sipas deklaratës së të pandehurit I. Sh., i njëjti këtë armë e ka hedhur në Liqenin e L..

10. Vendimi lidhur me paraturimin

Kryetari i trupit gjykues, ka vendosur që ndaj të pandehurit I. Sh., të ndërprehet paraturimi dhe i njëjti është liruar më datën 14.09.2015, ngase ka vlerësuar se nuk ka arsye për mbajtjen e mëtejme në paraturim.

Duke u bazuar në nenin 83 paragrafët 1 dhe 4 të KPRK, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që në dënimin e shqiptuar me burgim, të pandehurit I. Sh., i llogaritet edhe koha e kaluar në paraturim prej datës 10.08.2015 e deri më datën 14.09.2015, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraturim barazohet me 1 (një) të dënimit me burgim.

11. Kërkesa pasurore juridike

Kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin Xh. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk kanë paraqitur bazë të sigurt për gjykimin e plotë apo të pjesërishtë të kërkesës pasurore-juridike.

12. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit t'i detyrojnë për t'i paguar paushallin gjyqësor në shumë nga 50 Euro.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 28.09.2015

Sekretarja juridike,
Vahide Dërmaku

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.